

VENDIM
Nr.4, datë 17.1.2008

**PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIA GREEN ENERGY” SHPK PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (BLOK MOTORË-GJENERATORË TË
USHQYER ME BIOMASË TË LËNGSHME, SHËNGJIN, LEZHË) SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 39, pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 8 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike “ERE”, në mbledhjen e tij të datës 17.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Blok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Albania Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Blok motorë-gjeneratorë me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) si burim i rinovueshëm energjie.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta